



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	233/16
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	24.11.2016
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12.2 "d" të Ligjit nr.03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke u bazuar në kërkesën e Udhëheqësit të Zyrës Ligjore z.Idriz Muzaqi, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **24 nëntor 2016**, mori këtë:

**VENDIM
PËR AUTORIZIMIN E UDHËHEQËSIT TË ZYRËS LIGJORE PËR LIDHJEN E
PAJTIMIT GJYQËSOR**

1.Me këtë vendim përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës – Komunës së Vushtrrisë z. Idriz Muzaqi, autorizohet që të arrijë pajtim gjyqësor me përfaqësuesin e autorizuar të paditëses avokat Nexhat Beqiri lidhur me lëndën C.nr. 6/15, që në emër të:

1.1 Kompensimit të dëmit për rrënimin e shtëpisë të paditësit, në sipërfaqe prej 38.07 m² t'i kompensohet shuma prej 7,000.00 €;

1.2 në emër të shpronësimit të parcelës kadastrale nr.516-1 në sipërfaqe prej 40 m² t'i kompensohet shuma prej 520.00 € (ashtu si e ka vlerësuar Departamenti i Tatimit në Pronë) dhe

1.3 në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, shumën prej 624.60 €, ku përfshihen:

1.3.1 Për padi: 104 €;

1.3.2 për taksë gjyqësore: 15 €;

1.3.3 për pjesëmarrje në tri seanca gjyqësore: 405.60 €, dhe

1.3.4 për ekspertizë: 100 €;

1.4 totali i shumës e cila duhet t'i kompensohet paditëses është: 8,144.60 €.

2. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ta bëjnë ekzekutimin e pajtimit gjyqësor.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryetari i Komunës dhe Zyra Ligjore.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit dhe nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit.



Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit